



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 112, datë 06.06.2019**

**PËR**  
**MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE, NDAJ VLERËSUESIT TË DËMEVE NË**  
**SIGURIME Z. LEKË GJONI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pikës 2) dhe pikës 21), të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 235 dhe nenit 152, pika 1, germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

BSHS, me shkresën nr. 1192 prot. datë 18.02.2019, ka depozituar në Autoritet disa akte vlerësimi të hartuar nga ky vlerësues dëmsh, me kërkesën për rishikimin e tyre nga Autoriteti për shkak se janë hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Po kështu, Byroja Shqiptare e Sigurimit, me shkresën nr. 1617, datë 04.03.2019, ka dërguar një tjetër ankesë për vlerësuesin e dëmeve z. Lekë Gjoni, në lidhje me një akt vlerësimin (shitesë) të bërë në dy variante.

Z. Lekë Gjoni, vlerësues i pavarur i dëmeve në sigurime, është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas licencës nr. 105 me vlefshmëri nga data 31.10.2014 deri 31.10.2019.

Nga verifikimi i akteve të vlerësimit konstatohet se:

Z. Lekë Gjoni, gjatë veprimtarisë si vlerësues dëmsh në sigurime ka kryer akt vlerësime dëmi në disa variante për një ngjarje sigurimi.

Nga tre akt vlerësimet për të cilat është bërë ankim, në dy prej tyre vlerësimi është bërë në tre variante, duke u bazuar në Rregulloren nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, e ndryshuar, duke u bazuar në Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 12, datë 14.09.2007, si dhe në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, duke bërë që vlera e dëmshpërblimit të rritet në disa fish nga ajo që i takon në fakt sipas Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009.

Në rastin me vdekje të të ndierit z. Ajet Seferaj, përveç vlerësimit sipas Rregullores nr. 53, datë 25.06.2009 “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, në shumën minimale 1.359,205 lekë dhe maksimale 1,859,205 lekë, janë bërë dhe dy vlerësime të tjera në shumat minimale dhe maksimale përkatësisht 2,525,871 lekë e 3,859,205 lekë dhe 6,816,439 lekë e 10,692,539 lekë.

Po kështu edhe në rastin e z. Liman dhe zj. Fitnete Vata akt vlerësimi është bërë në dy variante me diferenca të konsiderueshme në variante të ndryshme.

Autoriteti, i ka dërguar shkresë vlerësuesit të pavarur z. Lekë Gjoni, duke e informuar rreth pretendimeve të BSHS-së dhe duke i caktuar takim pranë zyrave të AMF-së, në datën 19.03.2019, ora 09.00, për t'u dëgjuar për çdo sqarim apo observacion lidhur me këtë konstatim.

Në takimin e organizuar pranë zyrave të AMF-së, në datën 19.03.2019, midis përfaqësuesve të Drejtorisë së Zbatueshmërisë dhe vlerësuesit të pavarur z. Lekë Gjoni, nga ky i fundit është kërkuar kopje e ankesave të ardhura nga BSHS në adresë të tij.

Duke qenë se ankesa e ardhur nga BSHS, (në të njëjtën shkresë) përveç rasteve të vlerësuesit z. Lekë Gjoni, përfshinte edhe vlerësues të tjerë, ju dërgua shkresë me kopjet përkatëse vetëm për pjesën që i takonte z. Gjoni dhe ju la përsëri takim në datën 29.03.2019.

Në takimin e organizuar pranë zyrave të AMF-së, në datën 29.03.2019, z. Lekë Gjoni kërkoi kohë për të përgatitur me shkrim observacionet përkatëse për të gjitha rastet e pretenduara nga BSHS.

Bazuar në pretendimet e vlerësuesit të pavarur z. Lekë Gjoni, dhe të dokumentave të depozituara pranë zyrave të AMF-së në datën 04.04.2019, pretendohet se akt vlerësimet e dëmeve të mësipërme në disa variante, janë kryer me kërkesën e palëve ndërgjyqëse dhe detyrave të caktuara nga Gjykata, pasi është thirrur nga gjykata në cilësinë e ekspertit të pavarur, bazuar në nenin 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe konkretisht bazuar në vendimet e më poshtme:

- Për paditësen Behare Seferaj “Vendimi për caktimin e detyrave” nr. Regjistri 6561 Them. Datë 12.09.2018.
- Për paditësen Fatmira Fërfalla “Vendimi për caktimin e ekspertit” nr. 7750 Akti datë 02.07.2018 dhe “Vendimi për caktimin e detyrave shtesë” nr. 7750/1240 Akti. Datë 31.01.2019.
- Për paditësen Liman&Fitnete Vataj “Vendimi për caktimin e ekspertit” nr. 461-279-93 Akti datë 30.05.2018 dhe “Vendimi për caktimin e detyrave të ekspertit” nr.461-279-93 Akti datë 30.05.2018.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

### **V E N D O S I:**

1. Bazuar në nenin 152, pika 1) germa a) të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, urdhërohet vlerësuesi i pavarur z. Lekë Gjoni, si më poshtë:
  - i. Të kryejë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve;
  - ii. Të bëjë vlerësime të paanshme duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 233, të Ligjit nr. 52/2014.
2. Përsëritja e shkeljeve të mësipërme, do të jetë objekt i masave të përshkallëzuara konform legjislacionit në fuqi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve dhe Drejtoria e Zbatueshmërisë për njoftimet dhe ndjekjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Ervin KOÇI**